



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239715

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06054319

AC-I-23-0409

Në ankesën e

Paditësi

S A, Podujevë. - i Përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH "FAN "Zahir Pajaziti", Podujevë (në Likuidim) e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-3315 të datës 15 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-3315 i datës 15 qershor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 28 prill 2014, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN046-0494 të datës 26 dhjetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa që të kompensohet për ndërprerje të parakohshme nga NSH FAN "Zahir Pajaziti" (në likuidim). Në ankesën e tij, paditësi pohoi se ai ka të drejtë në paga të papaguara dhe se AKP-ja nuk ia ka refuzuar këto kërkesa mirëpo e njëjta pretendon se kërkesat e tij janë parashkruar.

Paditësi gjithashtu ka theksuar se kishte punuar në NSH për 21.69 vite, e që në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2001/27 të njëjtit i takojnë 4 paga mujore. Paditësi argumenton se bazuar në vendimin e refuzues të AL-së paga e tij bruto kishte qenë 200.00 €, e që i njëjti ka 21.69 vite stazh, dhe kështu duke u llogaritur për 4 muaj në shumën totale kapë vlerën prej 800.00 €, plus interesi. Si përfundim paditësi i kërkon Gjykatës që të anuloj vendimin e kundërshtuar të AL-së dhe të miratoj kërkesën e tij. Në mbështetje të ankesës së tij paditësi ka dorëzuar dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar të AL-së, Njoftimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës datë 24 mars 2006, lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) dhe Listën përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për përfitimin e një pjese të të ardhurave prej 20 % nga privatizimi / likuidimi i NSH-së, (faqen e parë, në të cilën figuron emri i ankuesit).

Me 29 janar 2020, e paditura AKP parashtroi mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankesa e parashtruar nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç parashihet nga neni 74.2 të Ligjit 06/L-086, e cila parasheh që ankesat e dorëzuara në DHPGJS, kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura pohoi se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara në ligj dhe kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, duke theksuar se kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo në ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL. Në mbështetje të

pretendimeve në këtë mbrojtje, AKP ka bashkëngjitur një kopje të vendimit mbi emërimin e anëtarëve të AL me nr. ref. DM 694/2019, datë 30 shtator 2019.

Me 22 shtator 2022, gjykata kishte lëshuar urdhër për ankuesin duke kërkuar që të dorëzoj prova shtesë në mbështetje të ankesës. Me 13 tetor 2022, përfaqësuesi i paditësit në përgjigje të urdhrit të gjykatës dorëzoi / ri dorëzoi, Listën / Tabelën për pranimin e Njoftimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës nga punonjësit e NSH-së dhe Listën përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për përfitimin e një pjese të të ardhurave prej 20 % nga privatizimi / likuidimi i NSH-së, (faqen e parë, në të cilën figuron emri i ankuesit).

Me 06 janar 2023, gjykata kishte lëshuar i urdhër për të paditurën, duke ia dorëzuar kësaj të fundit parashtresën e paditësit rreth provave shtesë të cilat i ka dorëzuar. Me 20 janar 2023, AKP-ja ka paraqitur përgjigje në këtë urdhër, përgjigje në të cilën i ri-përsëritë argumentet e shtruar në parashtresat paraprake. Në këtë përgjigje AKP-ja si prova shtesë bashkëngjit: Formularin për parashtimin e kërkesave nr. 11844/2013 i datës 26 shtator 2013, Njoftimin për shkëputje të marrëdhënies së punës datë 24 mars 2006, Kartelën e Bankës të ankuesit, Listën e rrogave të mbetura borxh ndaj ankuesit me nr. amzë 255, datë 24 mars 2006, dhe Librezën e punës.

Me 15 qershor 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-3315, me të cilin e ka aprovuar ankesën si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN046-0494 të datës 26 dhjetor 2013 dhe ka obliguar të paditurën AKP që paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të punës, t'i paguaj shumën prej 753.72 €, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 75.37 €. Shumat e aprovuara do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Gjithashtu ka obliguar të paditurën AKP-në, që në emër të taksës gjyqësore të paguaj në gjykatë shumën prej 20.00 € dhe që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 104.00 €.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të

dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuar).

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Tutja ka arsyetuar se sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle: 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore; 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore; 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore; 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore; 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;*

Shkala e I-rë ka vlerësuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH FAN "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë paditësi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj dhe nëse NSH ka obligime ndaj paditësit si paga të papaguara apo çfarëdo obligimi në emër të kompensimit për shkëputje të parakohshme, por kontestuese sipas te paditurës kontestuese ishte çështja e se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme është e parashkruar. E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës së paditësit dhe as lartësinë e kompensimit të kërkuar nga paditësi.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se nga lista përfundimtare e shpërndarjes së të hyrave nga 20 % i shitjes e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se paditësi kishte marrëdhënie pune me NSH FAN "Zahir Pajaziti" apo stazh pune prej 21.69 vite. Shkalla e I-rë e ka pranuar si prova relevante listën përfundimtare të shpërndarjes së të hyrave nga 20 % i shitjes, njoftimin e datës 24 mars 2006 si dhe pohimet e

tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të gjashtë pagave mujore në shumë prej 125.62 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme apo shumës totale prej 753.72 €, shkalla e I-rë është bazuar në nenin 76.7.7.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën që ka qenë në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pagë të cilën gjykata e ka llogaritur (11 paga në shumë totale prej 1,381.85 € = 125.62 €) si pagë mesatare të ankuesit në bazë të listës së rrogave të mbetura borxh ndaj ankuesit (me nr. amzë 255, datë 24 mars 2006, provë e cila është dorëzuar nga e paditura në mbështetje të përgjigjes së saj të datës 20 janar 2023) prandaj në mungesë të dëshmive gjykata nuk e ka marr për bazë pagën e llogaritur nga vetë paditësi në shumë mujore prej 200.00 €, pagë të cilën edhe e ka kërkuar paditësi me rastin e parashtrimit të ankesës në gjykatë. Shkalla e I-rë ka gjetur se aprovimi i gjashtë pagave mujore në shumën e aprovuar në emër të kësaj baze është brenda kufijve të shqyrtimit të vendimit të kundërshtuar të AL pasi ky kompensim rrjedh nga stazhi i tij i punës dhe si i tillë edhe është aprovuar nga gjykata.

Shkalla e I-rë e ka aprovuar edhe shumën në lartësi prej 75.37 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me 07 korrik 2023, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-3315 të datës 15 qershor 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0494 i datës 26 dhjetor 2013. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra

përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga viti 2006, prej kur paditësi nuk ka përfituara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Më 30 korrik 2024, përfaqësuesi i paditësit ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së të paditurës, me të cilën ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për hartimin e përgjigjes në ankesën e AKP-së ndaj aktgjykimit në shkallë të parë në shumën prej 208 euro, sipas nr. tarifor 9. Në përgjigjen e parashtruar përfaqësuesi i paditësit ka theksuar se i kundërshton pretendimet e të paditurës pasi që sipas të paditurës kërkesa është parashkruar ne bazë dy afateve, pasi që sa i përket afatit të parë paditësi e ka përmbushur këtë afat dhe prandaj Autoriteti i likuidimit ka vazhduar me ekzaminimin e meritave të kërkesës së tij, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi e ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Tutje ka shtuar se e kundërshton në tersi deklaratimet e të paditurës sa i përket afatit të dytë i cili ndërlidhet me parashkrimin e kërkesës, pasi që gjykata e ka konfirmuar se kërkesa e paditësit nuk ishte parashkruar dhe mbi këtë bazë ja ka njohur kompensimin paditësit.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 26 shtator 2013 ka paraqitur kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit pran AKP-së me të cilin ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të punës, por që AL me vendimin PRN046-0499 të dt. 26 dhjetor 2013, kërkesën e tij e ka refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, por edhe me parashtresat e dorëzuar gjatë procedurës si përgjigje ndaj të paditurës, kërkesën e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës e ka mbështetur me prova të mjaftueshme, duke dorëzuar përveç vendimit të Autoritetit të Likuidimit, Kopjen e njoftimit datë 24 mars 2006, lëshuar nga Agjencia, me të cilin paditësi është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke filluar nga data 24 mars 2006, listën e rrogave të mbetura borxh ndaj ankuesit me nr. amzë 255, datë 24 mars 2006, dhe Librezën e punës.

Me këto dëshmi paditësi padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë që të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën prej 753.72 euro, në bazë të përvojës së punës që ai e kishte në NSH.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën në Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ka sjellë njoftimin zyrtar të ish AKM-së me të cilën vërtetohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 24 mars 2006. Ky njoftim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Në bazë të këtij njoftimi, atë ditë është shitur Ndërmarrja në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës paditësit i është ndërprerë menjëherë. Në këtë njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësinë e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Paditësi duke u bazuar në këtë njoftim ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me datë 26 shtator 2013, andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar.

Prandaj duke u bazuar në provat e bashkangjitura, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që ai vendim nuk mbështetej në dispozita ligjore.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 korrik 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 15 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
